

Kronikë nga mbledhja e 25-të.

Shkup, 20.08.2015 – Në mbledhjen e sotme, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale solli Vendim për ndarjen e lejes për emetim televiziv të shërbimit programor përmes RRPKE që nuk përdorin resurse të kufizuara, në nivel rajonal për SHTR TV KOBRA SHPK Radovish dhe Vendim me të cilën lejohet ndryshimi i strukturës pronësore të SHTR RADIO SVETI NIKOLE SHPK Sveti Nikollë. Me qëllim të zbatimit të furnizimit publik, Këshilli i dha leje Drejtorit të Agjencisë për ndryshimin e vendimit për nevoja të furnizimit publik – shërbime botuese. Këshilli miratoi Vendimet e Drejtorit të Agjencisë për përzgjedhjen e një kompanie për përpilimin e dosjeve dhe pllakave informues edhe për shitjen e gjësendit të tundshëm përmes sistemit elektronik të ankandit publik.